REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER GENTJANA BRATI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.7, RRUGA GJERGJ FISHTA,
GODINA NR.9, AP. NR. 1, HYRJA NR.1
TEL: 0682032619

KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 890 **Nr. koleksioni: 263**

Tirane më 28/03/2022

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A202205384002809654 8

Akti noterial përbëhet nga 1 fletë

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 890 Rep.
NR. 263 Kol.

A20220538400280965 48

KONTRATË SHTESË KONCESIONI
PËR
NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT" (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) Nr.1139 Rep., Nr.437/3 Kol., datë 21.04.2017 PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GURI I BARDHË", E NDRYSHUAR"

Në Tiranë, më datë 28, muaji Qrs, viti 2022 (dymijë e njëzetë e dy), para meje noter _____ anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Tiranë, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 2363, datë 15.03.2022 (kopje bashkëlidhur) nga Z. , i datëlindjes , madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e te cilit u sigurova nga Letërnjoftimi me Nr.

DHE

Shoqërisë **"GealbEnergy" sh.p.k**, themeluar si person juridik datë 03.04.2017 dhe regjistruar në QKB datë 07.04.2017, me NUIS , e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z i datëlindjes madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e te cilit u sigurova nga Letërnjoftim me ID me Nr. personal

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) me Nr.1139 Rep., Nr.437/3 Kol., ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe shoqërisë "GealbEnergy" sh.p.k, (Koncesionari) për ndërtimin e hidrocentraleve "Guri i Bardhë" hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët datë 21 Prill 2017, e ndryshuar, me kontratën shtesë të koncesionit Nr.2545 Rep., Nr.1215/1Kol., datë 12.12.2018 "Amendim kontrate për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentraleve "Guri i Bardhë".

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritet Kontraktues) dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta: shoqërisë "GealbEnergy" sh.p.k, (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" me Nr.1139 Rep., [illegible] 2017, për ndërtimin e hidrocentraleve "Guri i Bardhë", (në vijim referuar si Kontrata e Koncesionit), e ndryshuar;

- Kontratës Shtesë të Koncesionit Nr.545 Rep., Nr.1215/1 Kol., datë 12.12.2018 "Amendim kontrate për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentraleve "Guri i Bardhë" të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "GealbEnergy" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve "Guri i Bardhë";

- Shkresës Nr.7922/1 Prot., datë 26.09.2018 "Miratohet projekti i zbatimit i hidrocentraleve Guri i Bardhë 1 dhe Guri i Bardhë 2" të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me anë të së cilës miraton projektin e zbatimit të shoqërisë "GealbEnergy" sh.p.k., referuar raportit të oponecës teknike të AKBN-së dërguar në MIE me shkresat Nr.6812/3 prot datë 20.11.2017 (prot i MIE-s Nr.9235 datë 28.06.2018) dhe Nr.5203 Prot., datë 28.05.2018, (prot i MIE-s Nr.7922 datë 29.05.2018).

  Shkresës së shoqërisë "GealbEnergy" sh.p.k Nr. 01 Prot., datë 21.02.2022 "*Kërkesë e përsëritur për amendim të kontratës së koncesionit dhe për ndryshim projekti*" protokolluar në MIE me Nr.1698 Prot., datë 21.02.2022 me anë të së cilës ka kërkuar amendimin e afateve kohore të kontratës duke ju referuar konkretisht afatit për marrjen e e lejeve të nevojshme për shkak të vonesave të shkaktuara nga institucionet shtetërore bazuar në argumentat e shoqërisë si më poshtë;

- Vonesa rreth 15 muaj në fazën e miratimit të projekt zbatimit pas problematikave që shoqëria "GealbEnergy" sh.p.k., ka ndeshur me shoqërinë "Mati Hydropower" sh.p.k për respektimin e pellgut ujëmbledhës të projektit të kaskadës së hidrocentraleve të Matit, ku pas arritjes së marrëveshjes me shoqërinë "Mati Hydropower" sh.p.k, dhe ndryshimit të projektit të zbatimit me deklarimin e palëve se nuk do të cënohet sasia e ujit që nevojitet për hirocentralet "Guri i Bardhë", referuar vlerësimit të grupit të oponencës teknike të AKBN-së, Autoriteti Kontraktues ka miratuar projektin e zbatimit të hidrocentraleve "Guri i Bardhë" për shoqërinë "GealbEnergy" sh.p.k, me shkresën Nr.7922/1 Prot., datë 26.09.2018, si dhe ka nënshkruar me shoqërinë kontratën shtesë të koncesionit Nr.2545 Rep., Nr.1215/1 Kol., datë 12.10.2018.

- Vonesa në procedurën e pajisjes me leje mjedisore (VNM) pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit dhe vonesa në procedurën e pajisjes me deklaratën mjedisore të cilat kanë ndikuar në miratimin e procedurës së marrjes me qera të fondit pyjor/kullusor nga bashkia Klos.

- Urdhërit të Ministrit nr.48 datë 30.01.2019 "Për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare" , i cili pezulloi për një afat të pacaktuar të gjitha procedurat e koncesionarëve deri në verifikimin e zbatimit me përpikmëri të kushteve dhe afateve kontraktore ku pjesë e këtij urdhëri ishte dhe shoqëria "GealbEnergy" sh.p.k, për hidrocentralet "Guri i Bardhë"

Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 pasojat e së cilës u ndjenë edhe për shoqërinë "Gealb Energy" sh.p.k, duke bërë që të pezullohej, për disa herë dëgjesa me banorët e komunitetit të zonës rajonale, të pajisjes së shoqërisë me deklaratën [illegible] e projektit të hidrocentraleve "Guri i Bardhë";

A20220538400280965 43

Si dhe;

- Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 24.03.2020 *"Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore"*, i ndryshuar, Aktit Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020 *"Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19"*, i ndryshuar,

- Referuar nenit 20 "Forca Madhore" pika 20.1 ku parashikohet se: "Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore" i Katastrofat Natyrore, përmbytjet, tërmetet, ndotjet nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me të"

- Palët njohin dhe pranojnë kufizimet dhe vonesat e shkatuara për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID-19" si dhe;

- Mbështetur në nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se;

- 28.1 Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe /ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve;
- 28.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo aneksëve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.
- Në nenin 29 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) me Nr. 1139 Rep., Nr. 437/3 Kol., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe shoqërisë "GealbEnergy"sh.p.k, (Koncesionari), për ndërtimin e hidrocentraleve "Guri i Bardhë", hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datë 21 Prill 2017 dhe e ndryshuar me Kontratën Shtesë të Koncesionit Nr.2545 Rep., Nr.1215/1Kol., datë 12.12.2018 të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Në nenin 10 "Programi i Punimeve" pika 2 zëvendësohet me shprehjen "Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 24 muajve nga data e marrjes së të gjithave lejeve për fillimin e punimeve. Afati për pajisjet me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi të kësaj kontrate shtesë të koncesionit.

Neni 2

Kjo Kontratë Shtesë koncesioni hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pas [illegible] e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

A20220538-10028096548

NOTER TIRANË

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES	**SHOQËRIA KONCESIONARE**
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	**"Gealb Energy" sh.p.k**
Përfaqësuar me Autorizim Nr. 2363, datë 15.03.2022 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga	**Përfaqësuar nga:**
	ADMINISTRATOR

Sh.p.k. NUIS : L 76607401 A BULQIZË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË